

URDHËR
Nr. 164, datë 12.3.2020

PËR MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, LOKALEVE, FAST FOOD DHE KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT

Në zbatim të nenit 7, pika 4 të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, në të gjithë vendin, deri në datën 3.4.2020.

2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.

3. Përdorimi i shërbimeve të bareve dhe restoranteve në strukturat akomoduese vetëm për qytetarët e akomoduar në strukturën akomoduese përkatëse, deri në datën 3.4.2020.

4. Strukturat akomoduese ndalohen të ofrojnë shërbim bar dhe restorant për qytetarë që nuk janë klientë të stukturës akomoduese, deri në datën 3.4.2020.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.

6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu